



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.823/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelet e Muhamet Selmanit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Muhamet Selmani nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me shenjen ZL.Anr.823, ZL.Anr.824 dhe ZL.Anr.825 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë Vendvotimet:1931E/03D, 1960E/02R, 1960E/03D

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën - **II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet e vendosura në dispozitiv të këtij vendimi me datën 09.11.2017, nga Muhamet Selmani kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë. Parashtruesi i apelit pretendon se në vendvotimet 1931E/03D në shkollën “Anton Zako Çajupi” në Jugoviq, 1960E/02R në shkollën fillore “Nexhmi Mustafa” Prugoc dhe 1960E/03D në shkollën fillore “ Nexhmi Mustafa” Prugoc në publikimin e shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ i mungojnë votat e elektoratit të tij, dhe pretendon se ka vota më shumë se sa iu janë publikuar nga KQZ. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur apelit

deklaratat e votuesve dhe Formularët e Rezultatit të Kandidatëve në këto vendvotime me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi.

Në apel kërkon nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimet e cekura.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.823/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura më lartë në pjesën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 823/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa